

Vleresimi Paraprak I Ndikimit ne Mjedis

ÇIPI KONSTRUKSION SHPK

Aktiviteti : Perpunim dhe prodhim i metaleve te celikut

Per : "Instalime per prodhimin dhe perpunimin e metaleve prej celiku"

Shtojca II Pika 4/1

Adresa: Durres RRashbull Shenavlash prane kabines elektrike

**Hartoi raportin e
Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:**

GBA studio



Tirane, 2016

Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis u pergatit nga
"Green Business Albania" shpk, me autore:

Ing. Dhurata Lumani



Ekspert Mjedisi Elgerti Bixha



PASQYRA E LENDES

1. Hyrje	5
2. Kuadri ligjor	7
3. Metodika e vleresimit	9
3.1 Analiza e gjendjes ekzistuese dhe vlerësimi i situatës	10
4. Përshkrimi i projektit	11
4.1 Prezantimi jo formal	11
4.2 Statusi i zonës në studim dhe Kuadri ligjor i realizimit Objektivit	11
4.3 Pozicioni i zonës së studiuar	12
4.4 Planifikimi funksional i zonës	13
4.5 Qëllimi i Projektit	13
4.6 Te dhena mbi shfrytëzimin e sipërfaqes se Sheshit te Sherbimit	13
5. Të dhëna për mjedisin ekzistues të zonës ku do te zbatohet projekti	14
5.1 Ekosistemet, habitatet dhe peisazhi ekzistues	14
- Flora.	14
- Fauna.	15
5.2 Popullsia, klima dhe infrastruktura ekzistuese	15
-Popullsia	15
- Klima	15
- Lagështia mesatare relative e ajrit.	16
- Reshjet atmosferike. -	16
- Infrastruktura	17
- Hidrografia	17
5.3 Tokat kategoria e tokes dhe gjeologjia.	17
Vendndodhja	18
Litostratigrafia	18
Te dhena hidrogjeologjike	18
Te dhenat sizmike	19
5.4 Uji, akuiferet, rruget ujore, brigjet etj.	19
5.5 Trashegimia arkitektonike dhe historike.	20
5.6 Peisazhi dhe topografia.	20
5.7 Tiparet e tjera mjedisore.	20
5.3 Tokat, kategoria e tokës dhe gjeologjia.....	21
6. Objektet Inxhinierike Te Lidhura Me Projektin	21
6.1 Rrjeti Inxhinierik	21
6.2 Furnizimi me ujë dhe shkarkimet e ujerave te zeza.	22
6.3 Evakuimi i ujerave sipërfaqësore.	22
6.4 Parkimi.	23
7. Identifikimi i ndikimeve më të rëndësishme në mjedis nga projekti gjate fazes Ndertuese.....	23
7.1 Punime ne thellësi ne territor urban me qarkullim intensiv	24
7.2 Ndotja e Ajrit	25

A. Ndotja e Ajrit nga mbetjet fluturake te ngurta	26
B. Emetimet ndotëse i mbetjeve te gazta te prodhuara gjate gërmimit apo transportit nga parku i automjeteve..45	
7.3 Zhurmat	26
7.4 Ndikimet ne ujërat sipërfaqësore.	26
7.5 Ndikimet ne ujërat nëntokësore.	27
7.6 Shkarkimet ne uje	27
7.7 Ndikimet në tokë dhe erozioni i saj.	27
7.8 Ndikimet e projektit në modelin drenazhues të zonës.	27
8. Masat Për Mbrojtjen Dhe Menaxhimin E Qëndrueshëm Të Mjedisit	28
8.1 Ngarkimi dhe transporti	29
8.2 Rrethimi i objektit	29
8.3 Ngritja e rrugëve të brendshme	30
9. Ndikimet në florë, faunë dhe gjeologji	31
9.1 Ndikimet ne flore, faune	32
- Flora	32
- Fauna	32
9.2 Përshkrimi i ndikimeve negative individuale dhe të grumbulluara në biodiversitet duke përfshire dhe ndikimet ndërkuftare.	33
10. Matricat përmbledhese të ndikimit në mjedis	33
10.1 tabela përmbledhëse të ndikimit negativ në mjedis	33
10.2 tabela përmbledhëse të ndikimit pozitiv në mjedis	33
11. Masat dhe ndikimet ne përdorimin e truallit	34
11.1 planifikimi i zonës.	35
11.2 ndikimet në përdorimin e tokës dhe të burimeve	36
11.3 masat estetike dhe ekologjike.	37
12. Përmbledhje e aspekteve pozitive dhe negative të ndikimeve të mundshme Mjedisore dhe sociale.....	37
a. Efekte pozitive	38
b. Efektet negative	39
13. Konkluzione dhe rekomandime	40

1. HYRJE

Shoqeria Çipi Konstruksion Shpk si aktivitet kryesor te saj ka :

-Perpunimin dhe prodhimin e strukturave metalike te tipit Magazina industrial.

Ne procesin e perpunimit te strukturave metalike perfshihen prerjet me sharre elektrike e elementeve metalike,shpimi I vrimave me trapan elektrik ,pastrami nga ndryshku,saldimi I ketyre elementeve me njeri tjetrin realizohet me saldatrice elektike me argon,gjithashtu pasi behet asamblimi I te gjithë elementeve realizohet procesi ilyerjes me boje.

-Pergatitje per ngarkim dhe transport

Pasi kane perfunduar proceset e mesiperme elementet e prodhura pergatiten per ngarkimin e tyre ne mjete transporti per dergimin ne kantjeret e ndertimit.

Emri I Subjektit : ÇIPI KONSTRUKSION SHPK

NIPT: L322075050

Adresa: Durres RRashbull Shenavlash prane kabines elektrike

Objekti I Aktivitetit

Ndertimin e cdo lloji godine si pallatet e banimit,ndertimet civile,industrial,turistike,bujqesore,qendra biznesi ,hotele ,bar-restorante,magazine,parkingje,komplekse te ndryshme turistike,ne zonat malore dhe tregtare,te depove stacionare per karburante dhe nenprodukteve te tyre si dhe rikonstruksioneve te ndryshme ndertimore etj,Ndertimin e urave,celjen dhe ndertimin e rrugeve te reja te autostradave te komunikacionit urban dhe inerterurban,asfaltimin e tyre.Kryerjen e punimeve per prodhimin dhe montimin e konstruksioneve metalike te cdo lloji dhe mikse, tregetin e tyre me shumice dhe pakice importin e makinerive dhe pajisjeve teknologjike dhe venien ne shfrytezim te linjave dhe reparteve per prodhime konstruksioni metalike dhe dhenien e asistences teknike per to.

Zhvillimi i shoqërisë njerëzore, sidomos në vitet e fundit, është mbështetur në shkallë të gjerë në shfrytëzimin e burimeve natyrore. Por nëse shfrytëzimi është më i madh se ripërtëritja e burimeve, vjen një ditë ku vihen në pikëpyetje edhe vetë ekzistenca e njerëzimit. Për këtë arsye, krahas shfrytëzimit, njerëzit në forma e mënyra të ndryshme kanë menduar për të ruajtur dhe mbrojtur mjedisin ose së paku pjesë të veçanta të saj. Në ditët e sotme mbrojtja dhe ruajtja e natyrës përfaqësojnë një shqetësim ndërkombëtar: takime dhe konventa të ndryshme dërkombëtare, në një pjesë të konsiderueshme të të cilave vendi ynë është pjesëmarrës (Konventa për mbrojtjen e detit Mesdhe, Konventa mbi ndryshimet klimaterike, Konventa mbi shumëllojshmërinë Biologjike e Biodiversitetin, Konventa e Ramsarit, Konventa e Aarhusit, e shumë të tjera). Vendi ynë, duke qenë anëtar i këtyre konventave ndërkombëtare, është i detyruar të zbatojë një sistem sa me efektiv, Ekonomik – Social – Mjedisor, për rregullimin e territorit sidomos në funksion të zgjidhjes së problemeve të ndryshme mjedisore. Mjedisi urban në Bashkinë Durrës, vendi ku do të ndërtohet Struktura, objekt i këtij Raporti Mjedisor, është një mundësi për përdorimin në raporte të pranuar të ligjit të urbanistikës.

Studimi urbanistik i kësaj zonë, synon të arrijë:

- *Rritjen e nivelit të standardeve ekonomike.*
- *Krijimin e një strukture urbane me orientim ekologjik.*
- *Të mbroje mjedisin .*
- *Të ruaje burimet natyrore dhe tiparet e pejsazhit.*
- *Të ndërtojë një rrjet të infrastrukturës inxhinierike për gjithë zonën e studiuar, si element bazë për mbrojtjen e mjedisit.*

Raporti i Ndikimit në Mjedis (V.N.M.), duke u bazuar në zhvillimin strategjik, përfshin planifikimin dhe masat zbutëse të ndikimit në mjedis, gjatë realizimit të këtij Projekti në këtë zonë, si dhe menaxhimin urban të saj.

E trajtuar me pika, Raporti i Ndikimit në Mjedis (V.N.M.) do të paraqesë:

- 1) Vlerësimin e ndikimit gjatë fazës së ndërtimit të objektit mbi mjedisin e zonës dhe shëndetin e njerëzve.
- 2) Evidentimin e faktorëve pozitivë dhe negativë mjedisore në këto faze të zhvillimit të projektit.
- 3) Skemat e rehabilitimit dhe masat zbutëse, njëkohshëm edhe reduktimin e impakteve negative.

2. KUADRI LIGJOR

Ky Raport i studimit të Ndikimit Mjedisor , përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimeve negative mbi mjedisin fizik dhe social gjate zbatimit te projektit ” Instalime për përpunimin e metaleve prej çeliku”

Ky proces paraqet prioritetet mjedisore , dhe përfshin masat qe Shoqëria Ndërtuese duhet te marre gjate ushtrimit te aktivitetit ndërtues për zgjidhjen e problemeve të mundshme me afektim negativ ne mjedis.

-Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”I ndryshuar.

-VKM-229-DATE-23.04.2014-Miratimine-rregullave-per-transferimin-e-mbetjeve-jo-te-rrezikshme

- Ligjit ``Per Lejet e Mjedisit`` Nr.10448 date 14.07.2011,I ndryshuar,

Ligjit Nr 60/ 2014 date 19.06.2014

-VKM Nr 13 date 04.01.2014 ``Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afatave per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis

-VKM nr.575,date 24.06.2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”

-Ligji 12.2015 date 26.02.2015 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440 datë 7.7.2011”Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”

-VKM nr. 686 datë 29.7.2015, Për miratimin e rregullave të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore

-VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja.

-VKM. Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”

-Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”

-Ligj Nr 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”. -Udhëzim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »

-Udhëzim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’

-Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”

-Udhëzimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”

-Udhëzim Nr 3, datë 17.05.2006 “Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga guroret”

-VKM. Nr 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse”.

-Ligji Nr 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.

-Ligji Nr 9115, datë 27.02.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotur”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.

-Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”

-Ligji Nr 8906, datë 06.02.2002 “Për zonat e mbrojtura”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.

-Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”

-Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave

3. METODIKA E VLERESIMIT

Qëllimi i hartimit te Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është të identifikojë pasojat e mundshme negative mjedisore që mund të shfaqën gjatë ndërtimit te shfrytëzimit të projektit te : “Instalime për përpunimin e metaleve prej çeliku” si dhe të përcaktojë e rekomandojë masat tekniko-organizative për zbutjen e faktorëve negativë, n.q.s. ekzistojnë dhe të atyre që mund të krijohen gjatë procesit te ndërtimit .

Ky Studim i Ndikimit në Mjedis , tenton të ndihmoje sa me shume të jete e mundur vendim-marrësit , nëpërmjet dhënies se informacioneve të mjaftueshme mjedisore, çka kontribuon edhe për lehtësimin e ndjekjes dhe monitorimit të aktivitetit të mësipërm nga subjektet përkatëse. Ky studim përfshin një përshkrim të zonës dhe objekteve zhvilluese, përshkon mjediset rrethuese dhe nen ekosistemin të cilit i përket. Ai identifikon ndikimet me të rëndësishme negative, ndikimet pozitive, jep masat zbutëse dhe ato kompesuese mjedisore.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis per ndertim te “Instalime për përpunimin e metaleve prej çeliku”, është bazuar në rëndësinë e hartimit te ketij Studimi sipas standardeve bashkëkohore, me qëllim përmbushjen e kërkesave të komunitetit social e shoqëror të zonës ku zhvillohet projekti, por njëkohësisht dhe në ruajtjen e pasurive natyrore dhe humane të territorit.

Për këtë arsye është bërë identifikimi i ndikimeve negative dhe pozitive të projektit, marrja e masave zbutëse ndaj efekteve negative, duke pasur parasysh sa ruajtjen e interesave ekonomike të investitorëve dhe masat orientuese për një zhvillim të qëndrueshëm te biznesit ashtu dhe mbrojtjen e interesave mjedisore te ambientit dhe komunitetit te zones.

3.1 Analiza e gjendjes ekzistuese dhe vlerësimi i situatës

Për të arritur një vlerësim sa me real të territorit , ne kete raport do te realizohen studime dhe analizuar situatën , duke evidentuar informacionin dhe problematiken ne pikat kyçe si:

- Kuadri administrativ
- Plani rregullues ekzistues(realizimet dhe mos realizimet, zonimi dhe identifikimi i nevojave)
- Pozicioni gjeografik dhe kufiri administrativ
- Relievi i azhornuar
- Të dhënat klimatike dhe hidrologjike
- Të dhënat gjeologjike
- Të dhënat mbi florën dhe faunën

- Kushtet sizmike
- Burimet territoriale ekonomike
- Historia arkeologjia dhe monumentet e kulturës
- Gjendja e popullsisë ekzistuese dhe tendencat e ndryshimeve
- Pronësia mbi trojet
- Të dhëna mbi infrastrukturën (rrugore, elektrike, ujësjellës, kanalizim, telefonike si dhe vendet e grumbullimit të mbetjeve urbane).
- Të dhëna mbi infrastrukturën sociale
- Strehimin
- Arsimi
- Punësimi
- Profili ekonomik
- Të dhëna për zonën përreth.

4. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

4.1 Prezantimi jo formal

Duke u mbështetur në ligjin 10 440 datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis”, Te ndryshuar ky aktivitet bë pjesë në shtojcën II, Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis : 4. Prodhimi dhe përpunimi i metaleve. b) Instalime për përpunimin e metaleve prej çeliku.

Ky raport Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (V.N.M.) do të japë një informacion të shkurtër për procesin teknologjik dhe strukturor të Objektivit “Instalime për përpunimin e metaleve prej çeliku”. Me tej mbi këtë informacion dhe analize, do të informojë mbi ndikimet pozitive dhe negative në mjedis në fazën e ndërtimit dhe vënies në shfrytëzim të objektit, si dhe masat që Investitori duhet të marrë për zbatimin e kriterëve të nevojshme përmbrojtjen dhe menaxhimin sa më racional të mjedisit.

Shumë prej vlerësimeve të detajuara rreth ndikimeve në mjedis mbështeten në informacionet inxhinierike që duhet të merren parasysh. Raporti i Vlerësimit do të identifikojë në mënyrë të qartë përfitimet pozitive dhe negative si dhe përcakton një “rezultat të përgjithshëm” për secilën prej tyre.

Gjithashtu vlerësimi kërkon të identifikojë nëse ndikimet janë direkte ose indirekte, të shmangshme ose të pashmangshme.

4.2 Statusi i zonës në studim dhe Kuadri ligjor i realizimit Objektivit

Zona ne studim ndodhet ne Rrashbull Shenavlash prane kabines elektrike nën administrimin e Bashkise Durrës, te rrethit Durrës. Zona ka relief fushor dhe ndodhet ne anën jug- perendimore te qendres se qytetit te Durrësit , ne nje distance rreth 2.0 km referuar Bashkise se Qytetit.

- a. Zona ne te cilën ndodhet prona është nje zone Ish Industriale periferike e qytetit te Durrësit
- b. Vitet e fundit funksionaliteti urban i zonës ka pësuar deformime funksionale prej flukseve Imigratore nga zonat rurale te Shqipërisë. Pra ne kete territor konstatohet nje zhvillim jo intensiv informal.
- c. Territori në studim nuk është i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejt në zonat e mbrojtura me ligj sikurse janë: parqet kombëtare, zonat ujore të mbrojtura, zonat me ndërtime me vlerë dhe zonat monumentale, të cilat ruhen në përputhje me planet e zhvillimit ekonomik të vendit.
- d. Zona ne fjale, nuk është e përfshirë në zonë buferike, te cilat ruhen në përputhje me planet e zhvillimit ekonomik të vendit, si dhe në strategjinë kombëtare të Mjedisit. Si rrjedhoje e përshkrimit te mësipërm, eshte i detyrueshëm hartimi dhe projektimi i nje sistemi ndërtimesh brenda kushtëzimeve urbane.

Si rrjedhoje e përshkrimit te mësipërm, eshte i detyrueshëm hartimi dhe projektimi i nje sistemi ndërtimesh brenda kushtëzimeve urbane.

4.3 Pozicioni i zonës së studiuar

“ÇIPI KONSTRUKSION” SHPK, Durrës, nga viti 2013 është pronë private e ndodhur në Rrashbull, Durrës, e cila është zona industriale e qytetit. Vendndodhja e saj është vetëm 1km larg Portit të Durrësit dhe 200 m nga kryqëzimi i dy rrugëve kryesore. Ajo ka 660 m² sipërfaqe pune të mbuluar. Zona ku zhvillohet aktiviteti i kompanisë është një zonë me zhvillim industrial (Rrashbull, Durrës).

Teknologjia:

Nga aktiviteti produkti përfundimtar jane struktura dhe karpenteri metalike. Si lende te pare perdoren produktet e celikut te cilat sigurohen nga importi dhe tregu vendas te cilat shoqerohen me certifikaten e cilesise si:

1. Llamarina metalike
2. Prokate Celiku
3. Profile celiku
4. Tubo celiku me seksion katror apo rrethor

Elementet ndihmes te teknologjise:

Energjia elektrike sigurohet nga rrjeti i shpërndarjes nëpërmjet kabinës elektrike. Objekti është i lidhur me rjetin 20kv. Duhet të ritheksojme se për zhvillimin e aktivitetit përdoret vetëm energji elektrike.

Uji: Uji që përdoret për pastrim sigurohet nga rrjeti i ujit të pishem. Magazina është e paisur edhe me një depozitë me kapacitet 500 litra e cila do të përdoret vetëm në rastet emergjente.

Lëndë ndihmëse në përpunim: Janë të gjitha veglat e punës që janë lëndë konsumi që duhen për të zhvilluar aktivitetin të tilla janë të shumta ku përfshijne të gjithë gurë smerilues, pasta të ndryshme pastrimi, vaj për mirëmbajtjen e makinerive e të tjera si këto.

Instalime për përpunimin e metaleve prej çeliku:

Përpunimi Për realizimin e produktit përfundimtar behet vetëm përpunimi i lëndës së parë konkretisht: duke prerë, përthyes, presuar, tornuar, kalandruar elementët e celikut të lartpërmëndur që nuk përdorin teknologji per shkrirje.

Makineritë kryesore me të cilat operohet për të realizuar produktin janë :

- Torno (5 cope) me i vogli me diameter D200 e gjatesi L=1500mm , me i madhi D500 L= 4000mm
- Torno per tubat e shkurter me vrime Shpindel 160mm. 1 cope
- Bareno me bango 1600x1600mm
- Freza universale 3 cope
- Limatrice me gjatesi te ndryshme 3 cope
- Stukatrice 1cope
- Trapano radiale 3 cope
- Tranxhe 2 cope
- Piegatrice 2 cope
- Bango plasma me permasa 3000x8000mm
- Presa hidraulike 2 cope
- Sharrë elektrike me ujë
- Saldatrice
- Gur Flessibël

Kapaciteti

Me numrin aktual të punojësve dhe makineritë që disponohen arrihet një volum pune (prodhim + montim) prej 20 ton/muaj, në rastet kur ka rritje kerkese, shtohet krahu i punës.

Infrastruktura

Kanalizimet e ujrave të bardha, Repartet janë të paisur me kanalizimet për shkarkimin e ujrave të bardha. Këto kanalizime lidhen me rjetin e jashtëm të kanalizimeve.

I gjithë sheshi është i drenazhuar dhe i paisur me kanalizime për shkarkimin e ujrave sipërfaqesore.

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri

Repartet janë paisur me impiant kundër zjarit dhe bombola me shkumë, dhe ofrojnë sinjalistikën si dhe mundësinë e daljes së menjeherëshme në oborr/ ambient të hapur.

Venddepozitimi i mbetjeve


Brënda territorit të magazinave, në një vënd larg saj është pika e grumbullimit të mbetjeve të cilat dërgohen në pikën e depozitimit të caktuar.



Pozicioni i reparteve ka të zgjidhura disa nga problemet më të rëndësishme në lidhje me anën funksionale si:

- Largësi të mjaftushme nga vëndet e banuara.
- Pranë fuqisë punëtore.
- Brënda nje teritori të studiuar nga ana urbanistike.
- Pranë rrugës nacionale.
- Larg zonave të mbrojtura, arkeologjike, shkollave, kopshteve, spitaleve etj.

Vendodhja



HARTE TREGUESE E VENDNDODHJES SE OBJEKTIT.
SH 1:1000



PROJEKT NR:	OBJEKTI:	INVESTITORI: Z. MIKEL ÇIPI ÇIPI KONSTRUKSION SHPK	PROJEKTOI: Ing. Almir MANE Lic. I
-------------	----------	---	--------------------------------------



N	E
41 20 10.00	19 28 52.02

Të përgjithshme

“ÇIPI KONSTRUKSION” SHPK është një kompani me aktivitet në fushën e industrisë mekanike. :

- Struktura metalike për kapanone industriale
- Struktura të ndryshme metalike
- Karpenteri metalike për ndërtimin të tilla si forma metalike, struktura ndihmëse metalike, struktura metalike për magazina dhe kapanone si dhe objekte të tjera metalike sipas kërkesave.



Përshkrimi i objekteve

Objektet janë ndërtime relativisht të reja, të mirëmbajtura apo rikonstruktura.

Teritori ku ndodhen repartet është mjaft i përshtatshëm për funksionimin e këtij aktiviteti pasi paraqet një sërë përparësish si:

- Shtrirja në afërsi të autostradës por edhe rrugës kryesore të zonës industriale, vendndodhja vetëm
- Sistem të siguruar të furnizimit me ujë
- Sistem të siguruar të furnizimit me energji elektrike
- Mundësi për zhvillimin korrekt të aktivitetit



Ambjentet Administrative

Gjithe kapanoni ndahet ne dy ambiente pune (reparte) : Reparti i vogël dhe Reparti i madh
Reparti i vogël - Reparti i vogël është afërsisht 85m i gjatë dhe 30m i gjërë, ka dalje në të dy oborret me nga 2 dyer. Në këtë repart zhvillohet dhe aktiviteti i kompanisë. Vetë reparti është shtruar me beton, dhe i pajisur me dritare për ndricim natyral të ambientit. Gjithashtu është i pajisur me sistem ajrimi natyral me fanar për qarkullim të ajrit.

Kapanoni është rreth 9m dhe në zonën e fanarit deri në 12m.

Ky ambient është i sistemuar në zona të ndryshme për magazinimin apo përpunimin e lëndës së parë pa ndarje me mure. Reparti është i pajisur me 2 vinç-ura që shërbejnë për transportin e brendshëm të produkteve në repart.

Reparti i madh- Reparti i madh është rreth 85m i gjatë dhe 42m i gjërë. Në këtë repart nuk është investuar shumë pasi reparti i vogël plotëson të gjithë nevojat për realizimin e kapaciteteve të kompanisë. Ai është i pajisur me 5 dyer, 2 nga të cilat dalin menjëherë në rrugë, ndërsa 3 të tjerat lidhen me oborret. Ky repart gjithashtu është i pajisur me dritare për ndricim natyral nga të gjitha anët dhe ma fanar për ajrosje natyrale , vetë kapanoni është rreth 13m dhe ne zonën e fanarit arrin 15m lartësi. Reparti është i pajisur me 2 vinç-ura që shërbejnë për transportin e brendshëm të produkteve në repart.

4.4 Planifikimi funksional i zones

Zona ne studim, vitet e fundit ka marre nje zhvillim urban duke u shndërruar nga nje zone me përdorim kryesisht industrial ne nje zone per sipërmarrjet industriale te prodhimit ,te aktiviteve me qellim komercial. Por ndërkohe vitet e fundit zona është ndikuar nga imigracioni i brendshëm , dhe pse nuk mund te themi se ndikimi eshte serioz , prania e disa vilave banimit , imponon marrjen ne konsiderate dhe ndikimin mjedisor ne kushtet e qendrave te banuara Pronat mbi te cilat do te zbatohet projekti ndodhen ne nje zone me potencial ndërtimor persa i përket zhvillimit urban.

Per zonën nuk ka ndonjë projekt master planor qe kushteton kondicione urbane. Gjithsesi gjykojme se per realizimin e planifikimit funksional të territorit duhet pasur parasysh harmonizimi i zhvillimit të zonës me situatën përreth të saj. Zonimi funksional do të projektoje territore homogjene duke bërë një ndarje të qartë të zonës së zhvillimit me atë të vetë zonës përreth. Zonimi funksional përcakton qartë sistemin rrugor që lidh zonën ne studim me rrugët ekzistuese.

Ne keto kushte, ky Studim merr përsipër jo vetëm zgjidhjen pjesore të problemeve mjedisore që mund të shkaktojë projekti, por dhe harmonizimin e tij funksional me zonën përreth , posaçërisht

konsiderimi i komunitetit shoqëror banues të zonës, por dhe kondicionet e strukturave industriale të zonës

5. TË DHËNA PËR MJEDISIN EKZISTUES TË ZONËS KU DO TE ZBATOHET PROJEKTI

Zona ku do të zbatohet projekti, tashme mund të përkufizohet fizikisht dhe konceptualisht si një zonë me potencial zhvillimi industrial urban në Durrës. Kjo zonë zhvillohet në reliev fushor. Studimi i propozuar do të zhvillohet në një zonë ish industriale, me pritshmëri ruajtjen e destinacionit universal të përdorimit: për qëllime komerciale dhe industriale.

Dhe pse në zonë konstatohen investime, gjykojmë se perspektiva racionale e zhvillimit të kësaj zonë do të jetë ajo Industriale.

5.1 Ekosistemet, habitatet dhe peisazhi ekzistues

- Flora.

Zona bën pjesë në brezin e shkurreve dhe drurëve mesdhetarë. Aktualisht nuk mund të flitet me për drurë apo dhe shkurret të larta natyrore në zonë. Në terren konstatohen barishte kënetore, dhe bimësi me tipologji Ferre. Kjo zonë dikur (dhe para viteve 90) ka qenë zonë dierr. Toka në përgjithësi është jo produktive dhe kënetore në zonë të caktuara. Toka kryesisht është ranore e kripëzuar, e përziere dhe me formacione trofike moçalore. Mungesa e produktivitetit e ka orientuar zhvillimin e hershëm të saj por dhe atë perspektiv drejt urbanizimit industrial.

Aktualisht zona është zhvilluar me objekte industriale (kapanone dhe njësi komerciale) si dhe Vila Informatë. Si rrjedhim zhvillimi i projektit objekt i këtij Studimi as nuk priret nga zhvillimi i flores dhe faunes por dhe as nuk ndikon mbi këto faktore mjedisore.

- Fauna.

Zona në studim nuk dallohet për botë të pasur shtazore. Për zonën në studim nuk zotërohet ndonjë material i hollësishëm. Prania e kafshëve në këtë zonë mungon si rezultat i potencialit të varfër të zinxhirit ushqimor të tokës por dhe i intensitetit ndërtimor në zonë. Në këto kushte, dhe ndërtimi i objektit në studim nuk ndikohet apo ndikon këtë faktor të rëndësishëm mjedisor të zonës.

5.2 Popullsia, klima dhe infrastruktura ekzistuese

-Popullsia

Popullsia në këtë zonë është heterogjene si rezultat i levizjeve të shumta të popullsisë nga zonat përreth. Popullsia në zonën përreth shfaq prirjen për një rritje të shpejtë në numrin e përgjithshëm, kjo si pasojë e rritjes së vazhdueshme të numrit të ndërtimeve me orientim rezidencial, komercial e argetues. Popullsia përreth zonës së ndërtimit është e përbërë nga një

popullsi autoktone . Zona eshte pjese autoktone dhe tradicionale e qytetit . Nuk konstatohen zhvillime informale ne zone. Infrastruktura sociale ka nevojte te modernizohet dhe te zhvillohet me tej ne shume pjese te zones. Dhe pse eshte ne qender te qytetit , mund ta cilesojme kete zone si Pazari Anadollak i Qytetit . Ambient pa orientim , i copetuar urbanikisht , i pa sistemuar apo gjerberuar , me nje zhvillim anarkik te trafikut njerezor dhe automjeteve .

- Klima

Klima e rajonit eshte mesdhetare me karakteristikat klimaterike te rajonit te Shqiperise qendrore. Klima e rajonit është mesdhetare me karakteristikat klimaterike të rajonit të Shqipërisë qendrore. Temperatura mesatare vjetore e ajrit luhetet rreth 15 - 16 -18° C, i njëjti nivel temperaturash është prezent gjatë gjithë vitit, me kulme të temperaturave të larta në muajt Korrik dhe Gusht me vlere 29.3°C si dhe me temperaturat më të ulta që vrojtohen gjatë muajit Janar ku temperatura mesatare është 7.3° C.

Temperatura mesatare vjetore e ajrit luhetet rreth 15.2o C, i njejt nivel temperaturash eshte prezente gjate gjithe vitit ,me kulme te temperaturave te larta ne muajt Korrik dhe Gusht me vlere 29.3 oC si dhe me temperaturat me te ulta qe vrojtohen gjete muajit Janar ne te cili temperaturat mesatare eshte 7.3oC. Lageshtia mesatare relative e ajrit : Durresi si nje zone bregdetare karakterizohet, nga nje lageshti relativisht e larte , me vlere mesatare vjetore 70% , Reshjet atmosferike : Nje element tjetet mjaft i rendesishem i karakteristikave klimatike ne kete rajo jane reshjet atmosferike. Sasia e reshjeve mesatare vjetore luhetet rreth 1000 mm. Muaji me i lagesht eshte muaji Nentor dhe muaji me i thate i vitit rezulton Korriku .

- Lagështia mesatare relative e ajrit.

Durresi dhe zona përreth saj karakterizohet, nga një nivel lagështie i ajrit relativisht i lartë, me vlerë mesatare vjetore 60%.

- Reshjet atmosferike.

Një element tjetër mjaft i rëndësishëm i karakteristikave klimaterike në këtë rajon janë reshjet atmosferike. Sasia e reshjeve mesatare vjetore luhetet rreth 1000 mm – 1800 mm. Muaji më i lagësht është muaji Nëntor dhe muaji me i thate i vitit rezulton Korriku.

- Infrastruktura

Karakteristike e kesaj zone jane kryesisht ndertesat me karakter industrial si dhe ndertesat banimi informale te ndertuara ne menyre kaotike. Si rrjedhim eshte zhvilluar edhe infrastruktura rrugore e cila paraqitet ne gjendje relativisht te mire teknike.

Infrastruktura rrugore ne zone eshte e sistemuar dhe permiresimi i saj edhe ne rruget dytesore do t'i japin nje orientim dhe nje zhvillim te vazhdueshem zones ne fjale, drejt ndertesave me

karakter industrial dhe komercial. Uji i pijshem ne kete zone sigurohet nga rrjeti i shperndarjes se ujesjellsit qe vjen nga Ujesjellesi i Fush Kuqes .

- Hidrografia

Në këtë rajon takohen ujërat nëntokësor në depozitat zhavorr dhe në një thellësi 2.7 m deri në 5.5 m por në puset e shpimit ai arrin të ngrihet dhe të stabilizohet në 0.6- 0.8 m thellësi dhe në varësi të stinës niveli i tyre ndryshon. Në këto ujëra është vërejtur dhe prania e gazrave të tretur si H₂S, NH₄, CH₄, etj. Në zonën ku do të hapet sheshi i ndërtimit vërehet se nuk ka burime sipërfaqësore. Në zonën e shfrytëzimit dhe përreth saj nuk ka zona të lundrueshme dhe nuk ndodhen lumenj, liqene dhe dete, prandaj gjatë shfrytëzimit nuk do të cenohen rrugët ujore, brigjet lumenjtë, dhe bregdetet etj.

5.3 Tokat kategoria e tokes dhe gjeologjia.

Zona ku eshte parashikuar ndertimi ka riliev fushor.Struktura e tij gjeologjike eshte kryesisht e perbere nga formacione ranore te zones.

Litostratigrafia

Sheshi Rrashbull gjendet ne afersi te bregdetit te Adriatikut, midis rruges se plazhit dhe autostrades Tirane-Durres. Ben pjese ne territorin bregdetar te inkluduar ne ish Keneten e Durresit, tashme te thare dhe te zene me ndertime. Zona Shkozet-Durres ze pjesen mbyltese te ish kenetes, ne anen jugore. Ne jug ngushtohet midis detit Adriatik dhe depozitimeve molasike te structures Shkallnuer–Kryemadh, ndersa ne veri vazhdon e zgjerohet midis formacionit mollasik te Currilave ne perendim dhe atyre te Shenavlash-Rreshbullit ne lindje. Ne afersi te rajonit eshte qytetit te Durrësit, i cili është një qendër e rëndësishme dhe qyteti i dytë në Shqipëri për nga numri i popullsisë. Në të ndodhet porti më i madh i vendit, gjithashtu ka dhe një mumur të madh plazhesh, të cilët preferohen shumë nga turistët e huaj dhe vendas. Krahu perëndimor laget nga deti Adriatik, ndërsa në veri të planshetit kemi derdhjen e lumit Erzen. Terreni në përgjithësi është fushor, me përjashtim të pjesës veriperëndimore që përbëhet nga një varg kodrash siç është ajo e Spitalës me lartësi 182m. Përsa i perket bimësisë, në afërsi të bregdetit predominon druri i pishës.

Ky rajon ndërtohet nga formacione molasike të Ultësirës Adriatike dhe depozitime kuaternare. Mesiniani (N13m) – formacionet molasike të Mesinianit përhapen në segmentin Durrës – Bishti i Pallës, përgjatë bregdetit adriatik. Veçohen tre pako që nga poshtë lart janë :N13m(b) – ranorë shtresë trashë dhe argjila. Trashësia 350m. N13m(c) – argjila, alevrolite. Trashësia 400m. N13m(d) – argjila, thjerza ranore, gipse (formacioni Mengaj). Trashësia 50 - 400m. Në hartë pakot e mësipërme nuk paraqiten të veçuara. Për segmentin Durrës – Porto Romano hartograhohen së bashku dy pakot e sipërme (N13m(c + d)), ndërsa për segmentin e Bishtit të

Pallës hartografohen së bashku dy pakot e mesme (N13m(b + c)). Plioceni (N2) – shtrihet transgresivisht mbi formacionet e Mesinianit. Rrafshi i

transgresioni ndiqet gjithkund nga Durrësi në Porto – Romano dhe në Bishtin e Pallës.

Një dalje e Pliocenit zhvishet edhe në pjesën lindore të dy planshetave veriorë. Plioceni ndahet në dy formacione, por në rajonin tonë zhvishet vetëm formacioni I poshtëm: Helmasi (N2H), i cili ndahet në tre pako, që nga poshtë lart janë : N2H(a) – ranorë, konglomerate dhe argjila,. Konglomeratet dhe ranorët përfaqësojnë bazën e transgresionit të Pliocenit mbi formacionet e Mesinianit. Trashësia 350 –

400m. N2H(b) – argjila, alevrolite, linza ranore. Trashësia 500m. N2H(c) – ranorë, argjila, alevrolite me linza konglomeratesh. Trashësia 400m. Kuaternari (Q) – ka përhapje të gjërë, duke zënë rreth 80% të sipërfaqes së këtij rajoni. Në sipërfaqe zhvishen vetëm depozitime të Holocenit. c, d, p, Qh – Holocen. Koluvione, deluvione, proluvione; argjila, alevrite, rëra, copa. Trashësia ë0 – 30m.

alQh1 – Holocen i hershëm. Aluvione, argjila, alevrite, rëra, zhavorre. Trashësia rreth 60m.

LQh2 – Holocen i vonshëm. Depozitime lagunore; argjila, alevrite, rëra të imta,

mbeturina dhe rrënjë bimësh. Trashësia rreth 50m. AlQh2 – Holocen i vonshëm. Aluvione, alevrite, argjila, rëra, zhavorre. Trashësia deri 10m DQh2 – Holocen i vonshëm. Depozitime detare; rëra zhure. Takohen edhe shkrifërime detare.

Te dhena hidrogeologjike

Ne aspektin hidrogeologjik ky shesh karakterizohet nga ujembajtje e vazhueshme, per vete faktin se sheshi eshte ne kuoten me te ulet, pothuajse ne nivelein e detit. Niveli i perhershem i ujrave nentokesore ketu eshte po ai i detit. Kemi te bejme me nje basen nentokesor pothuajse me ujra te ndenjura. Tendenca e dinamikës se ujrave eshte nga lindje ne perendim, por levizja eshte shume e ngadalte. Ne rast hapje themelesh apo kanalesh ujembajtja do te jete e larte. Ardhja e ujrave nga lindje drejt perendimit do te shtohet. Sedimentet si ato kenetore po ashtu edhe ato aluviale jane te paqendrueshme, germohen me eskavator lehtesisht.

Te dhenat sizmike

Ne pikpamje sizmike rajoni i Durresit ku ben pjese edhe sheshi i mesiperm eshte nje nder rajonet me te qeta. Gjendet larg thyerjeve te thella sismotektonike dhe dallohet per faktin qe shume rralle eshte kapur nga termetet. Sforcimet kryesore maksimale sipas mekanizmit te vatrave te termeteve te ndodhura ne Shqiperi jane me orjentim nga jugperendimi ne veri lindje me renie ne juglindje.

5.4 Uji, akuaferet, rruget ujore, brigjet etj.

Ne zonen ku do te hapen sheshet e ndertimit verehet se nuk ka burime siperfaqesore . Por per efekt te pranise ne zone bregdetare, por dhe thellesise se madhe te germimit ne grope , do te kemi prani te konsideruesme te ujrave nentokesore . Nuk parashikohet prej Hidrologeve qe prania dhe trajtimi i ketij faktori te ndikoje ne Mjedisin Akuaferer te zones . Gjithsesi duhet te theksojme se

ambienti geologjik i zones eshte ranor , ambient i cili ndikohet nga levizje infiltruese ujore me shpejtesi , fenomen i cili pritet te jete i pranishem gjate largimit te ujit nentokesor nga themelet . Sa me siper rekomandohet monitorim i posacem i menaxhimit te Ujerave Nentokesore gjate procesit te germimit dhe largimit nga gropa . Problem ndikues gjate menaxhimit te Ujerave Nentokesore do te jete dhe largimi I tyre nga Gropa e Thenelit . Rekomandohet nje bashkepunim intensiv me Bashkine per administrimin e largimit te ujerave te themelit.

5.5 Trashegimia arkitektonike dhe historike.

Nuk disponohet asnje material qe te evidentoje ndeshje te ketij projekti me zona te mbrojtura te Trashegimise kulturore apo te Zonave te Mbrojtura Arkeologjike . Gjithsesi rekomandohet qe Projekti te paiset me dokumentacionin e mevojshem ligjor te komunikimit administrativ ne Institutin e Mbrojtjes se Monumenteve dhe ate te Arkeologjise . Lidhja e objektit me rruget ekzistuese dhe aktiviteti i shfrytezimit te tij nuk cenon zonat e urbanizuara perreth.

5.6 Peisazhi dhe topografia.

Vendi i projektit dhe shfrytezimi i tij eshte zgjedhur ne menyre te tille, qe te zhvilloje dhe te nxjerr ne pah aktivitetin e studimit.

5.7 Tiparet e tjera mjedisore.

Gjate shfrytezimit te aktivitetit ne kete zone do te parashikohet te kete tipare te tjera mjedisore.

Ushtrimi i aktivitetit dhe lidhja e tij me zonat e rendesise se vecante.

Per zonen ne te cilen ushtrohet aktivitetit, nuk disponohet asnje dokumentacion apo objeksion mbi perfshirjen e tij ne zona te mbrojtura me ligj si: Rezervat kombetare natyrore, zone me interes te vecante shkencor, park kombetar, zone me bukuri te rralle natyrore, kanione dhe brigje te trasheguara, park rajonal dhe rural, park pyjor kombetar, rezervat lokal natyror, zone ujore e mbrojtur. Ne te nuk ka ndertime me vlera monumentale te lashta si dhe zone me rendesi arkeologjike. Projekti i shfrytezimit te ketij Objekti behet ne perputhje me planet e zhvillimit ekonomik te kesaj zone.

6. OBJEKTET INXHINIERIKE TE LIDHURA ME PROJEKTIN

6.1 Rrjeti Inxhinierik

Studimi i furnizimit me energji elektrike dhe rrjetit inxhinierik sipas studimit te projektit objekti ku ushtrohet aktiviteti “Instalime për përpunimin e metaleve prej çeliku” në Rrashbull Dures, bazohet në studimin urbanistik të zonës, në projekt-idetë arkitektonike të ndërtimeve të saj, në të dhënat e investitorit për konsumatorët e energjisë elektrike, në studimin mbi furnizimin me energji elektrike të zonës si dhe në mkushtet teknike të projektimit të Republikës së Shqipërisë. Për furnizimin me energji elektrike te objekteve do te instalohet rrjeti i tensioni te mesem dhe te ulet. Sidoqoftë fuqia përfundimtare do të përcaktohet nga projekti elektrik i zbatimit.

6.2 Furnizimi me ujë dhe shkarkimet e ujerave te zeza.

Pika e furnizimit dhe shkarkimet do të përcaktohet nga Ndërmarrja e Ujës-jellës dhe Kanalizimeve në baze të konsideratave të mësipërme. Si kriterë në zgjedhjen e trasesë së rrjetit të shkarkimeve përveç fleksibilitetit do te përdoren edhe kriterë të tjera si fakti që linjat të jenë sa më të shkurtra, të kalojnë në buze të rrugës ose trotuare dhe vende të sigurta edhe në të ardhmen (ku nuk parashikohet të kryhen punime apo të kthehen në truall ndërtimi), etj. Në përputhje me sasitë e harxhuara ditore të ujit për konsum, do të realizohet edhe rrjeti kanalizimeve, i cili do të bëjë të mundur evakuimin e ujerave të përdorura drejt një kolektori kryesor apo drejt një impianti i trajtimi jo kolektiv. Në çdo rast si në kalimin buze rrugës, në trotuare edhe me rastet e kalimit nën rrugë, instalimi i tubove do të zbatohet në përputhje me normat përkatëse.

6.3 Largimi i ujerave sipërfaqësore.

Evakuimi i ujerave sipërfaqësore do të realizohet nëpërmjet rrjetit përkatës të përbërë nga sistemi i kuletave dhe zgarave të vendosura përgjatë rrugëve, në përputhje me specifikimet e dhëna në projekt.

6.4 Parkimi.

Parkimi është parashikuar mbi toke. Për arsye funksionale, sipërfaqja e parkimit është ndarë në sipërfaqe të brendshme dhe sipërfaqe të jashtme. Për to janë respektuar gjerësitë e rrugëve dhe hapësira që nevojitet për një vend parkimi.

7. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE MË TË RËNDËSISHME NË MJEDIS NGA PROJEKTI

GJATE FAZES SE NDERTIMIT

Duhet te minimizohen ndikimet ne mjedis ne fazën ndërtuese duke implementuar Menaxhimin e Planit te Mjedisit (MPM). Te gjithë punimet e ndërtimit duhet te realizohen ne përputhje me kete MPM.

Masat lehtësuese te kërkuara per reduktimin e ndikimeve te ceshtjeve mjedisore te ndryshme inkorporohen me MPM te detajuar si me poshtë:

7.1 Punime ne thellësi ne territor urban me qarkullim intensiv

1. Sipas projektit , parashikohet ndërtimi i nje Objekti i cili do te jete pa kate nen toke , pra pa gërmime masive dhe te thella,
